



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
NJËSIA E PROKURIMIT

Data 9.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje automjesh për nevoja të bashkisë Shijak ”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV 34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

7.200.000 (shtate milion e dyqind mijë lekë) pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për hartimin e kriterëve kualifikuese Komisioni u bazua kryesisht në:

- Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”,
- VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **Liçencën e ushtrimit të aktivitetit (Tregtim automjetesh), sipas të dhënave të plotësuara në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i Vetdeklarimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2021,2022,2023), nga data e zhvillimit të procedurës të jetë sa 40 % e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Pasqyrat Financiare të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të certifikuara nga organet tatimore dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlere eshte brenda limiteve te percaktuara ne LPP VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nuk sjelle kufizim te konkurrences duke qene se marzhi prej 39% e fondi limit eshte nje vlere relativisht e ulet per nje OE i cili eshte i qendrueshem ne treg dhe krijon bindjen per AK per nje realizim me sukses te kontrates.

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme të realizuara me sukses, të një ose disa kontratave të mëparshme, gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën prej jo më pak se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

- Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë është brenda limiteve të përcaktuara në LPP VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nuk sjelle kufizim të konkurrencës. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 e ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog original (ose kopje të noterizuar) ose fletëpalosje për automjetin që oferton, ku në katalogun përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjejnë pasqyrim parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike). Për specifikimet teknike të kërkuara të cilat mund të mos jenë të pasqyruara në katalog OE duhet të paraqesë një deklaratë për plotësimin e tyre.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar*

3. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose kontratë bashkëpunimi me Servis të specializuar dhe të licensuar sipas rregulloreve të Republikës së Shqipërisë, për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj dhe licensën përkatëse.)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të garancisë së mjetit të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi.*

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallin e ofertuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë vendoset me qëllim që të sigurohet një zinxhir i sigurt dhe i pandërprerë për furnizimin e mallrave objekt kontrate në boshtin: Prodhues / Distributor Prodhuesi – Operator Ekonomik – Autoritet Kontraktor. Kjo kërkesë është një garanci për AK në lidhje me mallrat final të furnizuar, të cilët duhet të jenë tregëtuar dhe furnizuar përmes një prodhuesi të sigurt dhe serioz, dhe që siguron se mallrat janë prodhime origjinale.*

5. Operatori ekonomik, në rast se do të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit/ve, duhet të paraqesë një deklaratë nga prodhuesi i mjeteve që garanton mbulimin e periudhës së garancise së mjeteve për një periudhë minimumi 5 (pese) vjet ose jo më pak se 100 000 kilometrash (cila të plotësohet e para) nga dorëzimi i automjeteve. Në qoftë se operatori ekonomik është Distributor i Autorizuar, kjo deklaratë duhet të paraqitet nga vetë operatori ekonomik ku garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e automjeteve, gjate periudhës se garancisë; ku te specifikojë cilat nga pjeset teknike te automjetit jane brenda garancise.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kjo kërkesë vendoset me qëllim që operatorët ekonomikë të jenë serioze ne permbushjen e detyrimeve te cilat do te marrin persiper, per defekte te mundshme qe mund te shfaqen dhe kane lidhje me prodhimin e mallit dhe zevendesimin pjesisht apo teresisht te pjesev te difektuara, pa faj te perdoruesit*

6. Operatori ekonomik duhet te deklaroje se ne rast te shpalljes fitues per dy mjetet e kerkuara duhet te realizoje shenjat dalluese sipas zyres perkatese, logon e bashkise shijak sipas kerkesave te AK.

7. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me certifikate ISO ne perputje me objektin e prokurimit sipas standarteve SSH/UNI/EN ose SSH/ISO (e vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë):

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, secili operator duhet te dorezoj certifikatat e lartpermendura, sipas zërave të mallit që do të marrë përsipër të furnizojë sipas aktit të marrëveshjes

Argumentim: *Kërkesat e mësipërme janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

8. Operatori ofertues duhet të paraqesë çertifikatë konformiteti me standardet e Komunitetit Europian (të përkthyer dhe noterizuar), për automatizimin që ofron.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshu*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Bazuar në nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 13 dhe 76 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, komisioni i ngritur në zbatim të Urdhërit Nr. 12, datë 12.02.2024, “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit”, ka hartuar dhe argumentuar specifikimet teknike, sic janë paraqitur në relacionin perkates dhe në seksionin e specifikimeve teknike të DST. Specifikimet teknike janë hartuar sipas kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të bëra nga Sektori i Shërbimeve të Pergjithshme.

Janë mbajtur parasysh standartet duke përshtatur nevojat e institucionit për një performance të lartë të tregut. Komisioni ka haruaruar specifikime teknike të cilat të plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe

garancise per nje produkt cilesor i cili te jete konform nevojave per te cilin autoriteti do ti perdore ato.

Karakteristikat		
Viti i prodhimit	Jo me pak se 2023	
Gjendja e mjetit	I ri me 0 km	
Tipi i mjetit	Furgon me vende	
Numri i mjetve	8+1	
Permasat		
Gjatesia L (mm)	≥5250	5253
Gjeresia B (mm) me pasqyra	≥1990	1997
Lartesia H (mm)	≥1990	1990
Hapesira midis akseve D (mm)	≥3270	3273
Dyer	4	
Lende djegese	Nafte	
Cilindrata	≤ 2.2 litra	2199 cc
Fuqia	≥ 136 kf	177 kf
Lloji i kambios (kutia e shpejtesise)	Manual	6 shpejt man
Standarti i emetimit	≥ Euro 6	
Konsumi mesatar	≤ 8.5 litra / 100 km	
Ngjyra	E bardhe e zeze ose gri	
Sistemi i frenimit	ABS dhe ESP	
Sistemi elektrik	12 V konform normave CE	
Airbag	≥ per shoferin dhe pasagjerin	
Sistemi i drejtimit	Timon hidraulik-elektromekanik majtas	
Lidhja e telefonit me bluetuth	Android auto dhe Apple car	
Sistemi i kondicionimit	Ajer i kondicionuar perpara dhe prapa	
Dyer me rreshqitje per pasagjeret	2 dyer anesore me rreshqitje	
Mbyllje qendrore	Me pult	
Dritaret para	Me komandim elektrik	
Timoni	Me butona per komandimin e radios	
Xhamat e pasme	Nuance te erresuar	
Ekran Multimedia	≥ 8”	
Kroskot Digital	≥ 10”	
Rregullator automatik te shpejtesise	Cruise control	
Disqet- Gomat	≥ 16” ~ 215/65/R16	17

Kontroll i presionit te gomave	Monitorim i presionit te gomave	
Pasqyrat e jashteme	Me komandim dhe ngrohje elektrike	
Sensore parkimi para dhe mbrapa	PO	
Kamera monitorimi mbrapa	PO	
Ndihmesi i ruajtjes se korsise	PO	
Ndihmesi i kendeve te verbera	PO	
Ndihmesi i frenimit per shmangien e aksidentit perpara	PO	
Ndihmes per limitimin e shpejtesise	PO	

Garancia:

- Minimumi 5 vjet ose 100.000 km (kush të shfaqet e para)
- Mjetet të shoqërohen me fletë garancie ku të specifikohet çfarë mbulon operatori ekonomik
- Kryerja e shërbimit të parë profilaktik (vaj motori dhe filtrat) nga firma fituese brenda çmimit të mjetit.
- Mjetet te jene te pasitura me Gome rezerve , krik, xhiromakine.
- Mjetet te jene te paisura me trekendesh sigurie dhe kuti te ndihmes se shpejte
- Pas lidhjes se kontrates dhe shpalljes fitues te OE , mjetet te jene te regjistruara me targa , leje qarkullimi, sigurim per vitin e pare ndaj paleve te treta (TPL)

Viti i prodhimit

Minimumi 2023

Vendi i origjines: Automjeti të jetë i paisur me Çertifikatën e Konformitetit (CoC) të prodhuesit sipas normave të Komunitetit European (CE) të lëshuar nga prodhuesi, kjo e përkthyer dhe e noterizuar në shqip. ISO 9001 dhe ISO 14001

- **Afati i lëvrimit:**

Brënda 1 muaj nga lidhja e kontratës

Specifikimi i Materialeve: Si më sipër

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Si më sipër Specifikimet teknike janë ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit dhe përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njesia e prokurimit

Albiona Mehmeti / personi përgjegjës
Arjan Calliku anëtar / specialist i fushës
Helidon Kalleshi anëtar /shef sektori sherbimeve